



AGENCIJA ZA ZAŠTITU OSOBNIH PODATAKA



Agjencia Shtetërore për
Mbrojtjen e të Dhënave
Personale

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

MIDIS

AGJENCISË PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE TË REPUBLIKËS
SË KROACISË

DHE

AGJENCISË SHETËRORE PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE TË
REPUBLIKËS SË KOSOVËS

AGJENCIA PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE E REPUBLIKËS SË KROACISË
DHE

AGJENCIA SHETËRORE PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE E REPUBLIKËS SË
KOSOVËS

(në tekstin e mëposhtëm: Nënshkruesit)

Duke pasur para sysh marrëdhëniet miqësore midis dy vendeve dhe rëndësinë e vazhdimit dhe përforsimit të marrëdhënieve bilaterale në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale.

Me dëshirën që edhe më tej të zhvillohet bashkëpunimi midis dy vendeve të orientuara në thellimin dhe përforsimin e procesit të zbatimit të ligjeve përkatëse nga fushëveprimi i Nënshkruesve, dhe për realizimin e synimeve të përbashkëta duke mbrojtur identitetin e tyre të ndryshëm.

Të bindura që ky memorandum do të promovojë marrëdhëniet e mira dhe do të krijojë kushte të favorshme për mbrojtjen efikase të privatësisë së qytetarëve të Republikës së Kroacisë dhe Republikës së Kosovës.

Me angazhimin për ndihmë të ndërsjellët në bazë të parimit të reciprocitetit në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale.

Të vetëdëshme për ekzistimin e bazës përkatëse ligjore në ligjet kombëtare, në Konventën për mbrojtjen e personave për sa i përket përpunimit të automatizuar të të dhënave personale (Konventa 108), në Protokollin Plotësues në saxe të Konventës për mbrojtjen e personave për sa i përket përpunimit të automatizuar të të dhënave personale lidhur me organet mbikëqyrëse dhe shkëmbimit ndërkombëtar të të dhënave, si dhe në Udhëzimin rreth mbrojtjes së individëve për sa i përket përpunimit të të dhënave personale dhe rreth qarkullimit të lirë të të dhënave të tilla

të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit Evropian (EU Directive 95/46/EC të vitit 24.10.1995), Nënshkruesit,

Lidhin këtë marrëveshje:

Neni 1. Objekti i Memorandumit

Nënshkruesit, përmes organeve kompetente, vërtetojnë dëshirën e tyre për zhvillimin e mëtejshëm të marrëdhënieve midis Republikës së Kroacisë dhe Republikës së Kosovës, si dhe dëshirën për avancimin e rolit të tyre në tërë regjionin (në nivel të Evropës), në kuadër të garantimit të të drejtave dhe lirive të njeriut, veçanërisht në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale.

Neni 2. Fusha e Bashkëpunimit

Bashkëpunimi do të zhvillohet në bazë të këtij memorandumi përmes nxitjes së aktiviteteve të ndryshme, veçanërisht dhe pa kufizime, si në:

- a. Shkëmbimin e përvojave bashkëkohëse me qëllim të përparimit të veprimtarisë në sferën e Nënshkruesve;
- b. Shkëmbimine rezultateve të hulumtimeve, studimeve, analizave, etj., nga fusha e mbrojtjes së të dhënave personale;
- c. Shkëmbimine ekspertëve për qëllime të përsosjes profesionale në nivel më të lartë;
- d. Bashkëpunimin në sferën e aftësisë (kualifikimit) profesional;
- e. Organizimin e takimeve për t'u konsultuar rreth çështjeve me interes të ndërsjellët, dhe konsultimit për të marrë masa të posaçme në zbatimin e masave të përbashkëta;
- f. Shkëmbimin e ekspertëve në përputhje me nevojën e marrjes së informacioneve të reja lidhur me mënyrat dhe metodat të cilat përdoren në segmentet e caktuara të punës së nënshkruesve;
- g. Shkëmbimin e informacioneve rreth përditësimit të kornizës ligjore të të dyja vendeve nga fushëveprimi i nënshkruesve;
- h. Organizimin e aktiviteteve në interes të përparimit të punës së nënshkruesve;
- i. Nxitjen dhe mbështetjen në përpunimin e dokumenteve ndërkombëtare, në dhënien e mendimeve, në paraqitjen e kërkesave për akreditim, etj., në përputhje me standardet evropiane;
- j. Bashkëpunimin për realizimin e programeve të përbashkëta arsimore kombëtare dhe ndërkombëtare me interes të dyanshëm në përputhje me qëllimet e këtij memorandumi;
- k. Veprimin për krijimin e kornizës së përbashkët të bashkëpunimit midis organeve të interesuara për përparimin e punës në fushën e mbrojtjes së të dhënave personale.

Neni 3.
Komunikimi midis Nënshkruesve

Me qëllim të realizimit të bashkëpunimit nga neni 2 i këtij memorandum, nënshkruesit komunikojnë drejtpërdrejt, edhe atë:

- a. Në formë të shkruar, kurse në raste urgjente edhe gojarisht, por çdo kërkesë gojore duhet të konfirmohet në formë të shkruar në afatin më të shkurtë;
- b. Kërkesat për dërgimin e infomacioneve do të shkruhen në gjuhën angleze ose në ndonjë gjuhë tjetër sipas marrëveshjes së nënshkruesve;
- c. Çdo informacion që transferohet, nuk guxon ti jepet palëve të treta gjersa për të nuk ka pëlqim nga pala tjetër;
- d. Nënshkruesit do të emërojnë personin përgjegjës për zbatimin e këtij memorandum;
- e. Personi përgjegjës do të jetë në dispozicion në çdo çast për komunikim dhe koordinim të bashkëpunimit;
- f. Nënshkruesit në marrëveshje do të rregullojnë radhitjen e takimeve me qëllim të zbatimit të këtij memorandum.

Neni 4.
Raporti me Dispozitat tjera

Ky memorandum nuk ndikon në të drejtat dhe obligimet, të cilat dalin nga marrëveshjet ndërkombëtare, palë e të cilave është Republika e Kroacisë dhe Republika e Kosovës, respektivisht nga anëtarësimi i tyre në organizatat ndërkombëtare, e as nga ligjet e tyre apo akteve nënligjore.

Neni 5.
Zgjidhja e Kontesteve dhe Prishja e Memorandumit

Me qëllim të zgjidhjes së kontesteve, nënshkruesit mund të paraqesin kërkesë me shkrim për konsultime.

Konsultimet zhvillohen më së largu tridhjetë ditë nga dita e pranimit të kërkesës në formë të shkruar.

Nënshkruesi mund ta anulojë këtë memorandum nëse e informon me shkrim nënshkruesin tjetër për anulimin.

Në rast se hiqet dorë nga paragrafi 3 i këtij neni, memorandumit shpallet i pavlefshëm në ditën e parë pas skadimit të afatit të anulimit prej gjashtë muajsh nga dita kur pala me të cilën prishet marrëveshja e ka pranuar njoftimin me shkrim nga paragrafi 3 i këtij neni.

Me skadimin e afatit të prishjes së marrëveshjes nga paragrafi pararendës, ky memorandum nuk vlen më.

Neni 6.
Dispozitat Përfundimtare

Ky memorandum hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga të dyja palët.

Ky memorandum nënshkruhet për afat të pacaktuar kohor.

Ky memorandum mund të ndryshohet me pajtim të dyanshëm në formë të shkruar.

Memorandumi është lidhur në Prishtinë, më 08 gusht 2012, në gjuhën zyrtare kroate dhe shqipe, në katër ekzemplarë, nga dy në secilën gjuhë. Të gjithë ekzemplarët konsiderohen origjinalë.

**PËR AGJENCINË PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
TË REPUBLIKËS SË KROACISË**

Dubravko BILIĆ, Drejtor



Dt: 08. 08. 2012

**PËR AGJENCINË SHETËRORE PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

Ruzhdi JASHARI, Mbikëqyrës Shtetëror Kryesor


